

Vendim nr. 269, datë 28.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 28.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (Sh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQATA ASOCIACIONI KOMBËTAR I MEDIAS DHE DREJTËSISË**, përfaqësuar nga kryetari Gjergji Zefi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i nenit 3 të ligjit nr. 96/2018, datë 03.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, në pjesën ku parashikon heqjen nga neni 53, shkronja “j”, i ligjit nr. 92/2014 të togfjalëshit “dhe nga media elektronike”, si i papajtueshëm me Kushtetutën.**

Detyrimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si pasojë e shfuqizimit të pjesshëm të nenit 3 të ligjit nr. 96/2018, datë 03.12.2018, që brenda një afati të arsyeshëm të miratojë një regjim fiskal të qartë, objektiv, transparent, jodiskriminues dhe neutral ndaj teknologjisë për median informative, duke garantuar trajtim të barabartë për median elektronike, median online/digjitale, portalet informative, publikimet periodike informative dhe çdo formë tjetër të komunikimit publik që kryen funksion informues.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, 7, 15, 17, 18, 22, 23, 116, 124, 131, pika 1, shkronja “a”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 10 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I****Rrethanat e çështjes**

1. Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji për TVSH*), i cili ka vendosur tatimin mbi vlerën e shtuar, i cili është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin. Ky ligj i është nënshtruar disa herë shtesave dhe ndryshimeve, ndër të cilat edhe ndryshimit me ligjin nr. 96/2018, datë 03.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 (*Ligji Ndryshues*).

2. Ligji për TVSH-në në nenin 53 ka parashikuar furnizimet e përjashtuara nga TVSH-ja, ndër të cilat, furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat, furnizimi i gazetave, i revistave dhe i librave të çdo lloji, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike (shkronja “j”). Me Ligjin Ndryshues fjalët “dhe i librave”, si dhe “dhe nga media elektronike” hiqen (neni 3 i Ligjit Ndryshues).

3. Shoqata Asociacioni Kombëtar i Medias dhe i Drejtësisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 04.05.2026 me kërkesë me objekt konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 3 të Ligjit Ndryshues në pjesën ku parashikon heqjen e togfjalëshit “dhe nga media elektronike” nga neni 53 i Ligjit për TVSH-në dhe detyrimin e Kuvendit të miratojë një regjim fiskal të qartë, objektiv, transparent, jodiskriminues dhe neutral ndaj teknologjisë për

median informative. Pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, kjo kërkesë është regjistruar në datën 19.05.2026.

II

Pretendimet e kërkueses

4. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se dispozita e kundërshtuar ka cenuar:

- 4.1. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi trajtimi i ndryshëm i medias *online* dhe digjitale, vetëm për shkak të formës teknike të shpërndarjes së informacionit, krijon një diferencim artificial, të pajustificuar dhe jo në përputhje me realitetin bashkëkohor të komunikimit publik. Në këtë mënyrë cenohet edhe neutraliteti teknologjik. Mediat *online* dhe digjitale nuk mund të vendosen në pozitë më pak të favorshme vetëm sepse nuk përdorin formate tradicionale të transmetimit, për sa kohë kanë të njëjtin objekt funksional, informimin e publikut. Nëse këto forma të medias trajtohen në mënyrë më të pafavorshme fiskale, atëherë ligji krijon një pengesë indirekte për konkurrencën, për pluralizmin dhe për zhvillimin e burimeve të reja të informacionit. Shteti nuk mund të trajtojë ndryshe subjekte që kryejnë të njëjtin funksion, pa dhënë një arsye objektive, të qartë dhe proporcionale. Po kështu, ligji parashikon trajtim të posaçëm edhe për furnizimin e librave të çdo lloji. Ligji ka krijuar një regjim të fragmentuar, ku trajtimi fiskal varet nga forma e furnizimit ose nga kategoria teknike e medias, dhe jo nga roli që media luan në garantimin e lirisë së shprehjes dhe të së drejtës për informim. Pabarazia fiskale shndërrohet në pabarazi në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe në kufizim indirekt të së drejtës së publikut për të marrë informacion të lirë, plural dhe të pavarur. Trajtimi i medias digjitale me normën standarde 20%, ndërkohë që media elektronike/audiovizive dhe kategori të tjera të lidhura me informimin përfitojnë trajtim më të favorshëm, përbën një diferencim të pajustificuar dhe antikushtetues. TVSH-ja nuk është thjesht një detyrim kontabël, por një faktor që ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e mediave digjitale për të mbijetuar në treg dhe për të prodhuar informacion cilësor. Shteti ka barrën të provojë se trajtimi i ndryshëm ndjek një qëllim legjitim dhe se ekziston një lidhje e arsyeshme ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar.

- 4.2. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi ndonëse ndërhyrja është bërë me ligj dhe për një interes publik, ajo nuk është proporcionale. Ndonëse masa është pjesë e politikës tatimore dhe për këtë arsye i përket vetëm diskrecionit të ligjvënësit, ky diskrecion nuk është i pakufizuar. Kjo ndërhyrje ligjore nuk përmbush *testin e nevojshmërisë*, pasi nuk provohet që trajtimi më i rëndë i medias digjitale/online është i vetmi mjet për arritjen e qëllimit fiskal; *testin e përshtatshmërisë*, pasi nuk tregohet një lidhje e arsyeshme dhe koherente ndërmjet qëllimit fiskal dhe trajtimit të ndryshëm të medias digjitale/online; *testin e proporcionalitetit*, pasi pasoja e masës është dobësimi i mediave më të vogla dhe rritja e varësisë së tyre nga financues të jashtëm, pra dëmi kushtetues tejkalon përfitimin fiskal dhe krijon efekt frenues. Ky dëm është ekonomik, profesional, institucional dhe publik. Qëllimi fiskal i shtetit është legjitim, por mjeti i zgjedhur nuk rezulton kushtetues nëse ai krijon trajtim të ndryshëm, pa arsye objektive dhe proporcionale, ndërmjet medias elektronike/audiovizive dhe medias digjitale/online që kryejnë të njëjtin mision kushtetues. Trajtimi më i rëndë i medias digjitale/online nuk rezulton të jetë i domosdoshëm ose i lidhur në mënyrë të veçantë me mbrojtjen e sistemit fiskal dhe nuk arrin të ruajë ekuilibrin e drejtë ndërmjet interesit të shtetit për të mbledhur të ardhura dhe interesit kushtetues për mbrojtjen e medias së lirë dhe pluraliste.
- 4.3. *Lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit, radios dhe televizionit, si dhe të drejtën e informimit*, të garantuar nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, pasi ky ndryshim ligjor e bën ushtrimin e lirisë së medias më të vështirë, më të kushtëzuar dhe më të varur. Këto liri nuk janë privilegje të pronarëve të medias dhe as përfitime ekonomike të subjekteve mediatike, po qëllimi është të sigurojnë që publiku të ketë akses në informacion, analiza dhe burime të ndryshme lajmesh. Një regjim fiskal që dobëson disa forma të medias informative nuk prek vetëm operatorët ekonomikë që paguajnë TVSH-në, por edhe publikun, sepse ul mundësinë që qytetarët të kenë qasje në informacion të larmishëm, të pavarur dhe cilësor. Për shkak të barrës fiskale një media online ka më pak mundësi të ruajë pavarësinë editoriale, pra e drejta e saj për të ushtruar lirinë e shprehjes cenohet në mënyrë reale. Njëkohësisht, qytetarët preken në të drejtën e tyre për t'u informuar.

4.4. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi barra fiskale ndikon në mundësinë e medias për të investuar në gazetari cilësore, për të mbajtur staf profesional, për të realizuar investigime dhe për të verifikuar informacionin, duke prekur interesin ekonomik të subjektit mediatik. Në rastet kur tregu është i vogël, të ardhurat nga reklamat janë të kufizuara, burimet e financimit nuk janë gjithmonë transparente dhe aktorët e pavarur kanë më pak mundësi ekonomike për të konkurruar dhe çdo barrë shtetërore ka efekt më të fortë sesa në një treg të konsoliduar. Një barrë që për një media të madhe mund të jetë e përballueshme, për një media lokale, *online*, investigative ose të pavarur mund të jetë pengesë serioze për vazhdimin normal të veprimtarisë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

5. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 43, datë 24.07.2025; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për legjitimimin e organizatave, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për sa i përket legjitimitetit *ratione personae*, Kolegji çmon se kërkuësja legjitimohet si *aspektin formal*, pasi kërkesa është paraqitur nga kryetari i shoqatës, shtetasi Zef Gjergji, ashtu

edhe në *aspektin substancial*, pasi ka justifikuar interesin e drejtpërdrejtë në çështjen në shqyrtim, për sa kohë ajo ka kundërshtuar ndryshimet në legjislacionin për TVSH-në, me të cilat është shfuqizuar dispozita që parashikonte përjashtimin nga ky tatim të medias elektronike.

8. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, Kolegji evidenton se kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Ligji Ndryshues nr. 96/2018 është miratuar në datën 03.12.2018, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018 dhe ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2019. Kërkesa është paraqitur në datën 04.05.2026, pra jashtë afatit ligjor 2-vjeçar.

9. Kolegji vëren se kërkesa është paraqitur dukshëm jashtë afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës, ndërsa nga përmbajtja e kërkesës nuk rezulton që kërkuësja të ketë paraqitur ndonjë argument në lidhje me këtë fakt, pra paraqitjen e kërkesës tej afatit ligjor. Kolegji thekson se ky afat fillon nga data e hyrjes në fuqi të aktit normativ që kundërshtohet dhe nuk ndikohet as nga momenti i krijimit të kërkuëses, si shoqatë, pra nga koha kur ajo ka marrë dijeni për aktin. Për rrjedhojë, edhe fakti që kërkuësja është themeluar në datën 28.01.2026 nuk përbën rrethanë që pezullon, ndërpret ose rivendos afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës. Për sa kohë ligji nr. 96/2018 ka hyrë në fuqi në janar 2019, ndërsa kërkesa është paraqitur vetëm në datën 04.05.2026, ajo rezulton të jetë paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor, për këtë shkak kërkesa nuk plotëson kushtin e legjitimit *ratione temporis*.

10. Në kushtet kur kriteret e legjitimit janë kumulative dhe kërkuësja nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, nuk mund të vijohet me shqyrtimin e mëtejshëm të kriterit *ratione materiae*.

11. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.